



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 14

Datë: 16. 05. 2017, ora: 15:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor

3. Raport i Këshillave të KQZ-së;

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore;**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Sigurisë për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017,*

- *Shqyrtimi dhe miratimi i nominimeve nominimeve për Anëtar të KKZ-ve,*

- *Shqyrtimi i Dizajnit të Doracakut për procedurat e votimit dhe numërimit.*

4. Shqyrtimi i Memorandum Mirëkuptimit mes KQZ-së dhe Zyrës së BE-së, për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme

4. Të ndryshme

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Sot, e kemi mbledhjen e 14-të të Komisionit Zgjedhor me rend të ditës të propozuar, si në vijim. Rendin e keni para jush. A ka dikush ndonjë propozim për ndonjë pikë shtesë...? A kemi ndonje ndryshim ?

Enis Halimi: Me falni, por propozimi i Sekretarit të Komisionit të Zgjedhjeve ka të bëjë me një proces të filluar të ndryshimit të rregullores së punës me disa obligime tona në kuptimi administrativ që reflektohen me disa ndryshime që lidhen me menaxhimin financiar në procesin zyrtar financiar. Unë kërkoj nga ju që, të futet në rend të ditës në mënyrë që të procesiojmë sa më shpejt. Konsideroj që do të duhet të bëhet një miratim il një ndryshimi të tillë që të hapen edhe rrugët që të mos na kontestohet asgjë nga ana e kuptimit financiar...

Valdete Daka: Faliminderit. Kush është për këtë rend të ditës dhe për këtë propozim të kryeshefit ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor

Enis Halimi: Sekretariati ka vijuar aktivitet e veta në funksion të përmbushjes së obligimeve të tij që kan të bëjnë me procesin zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme të 11 qeshorit. Jemi në proces të krijimit të Listës së Votuesve bazuar në ekstraktin e Regjistrimit Civil. Divizioni i Shërbimit të Votuesve, ka bërë caktimin e votuesve në 91 qendra të reja të votimit dhe po ashtu, një pjesë, e ka bërë edhe përmes zyrtareve tonë ekzekutive, ka bërë edhe caktimin në mënyrë manuale të votuesve lidhur me operacione të votimit përmes postës. Në bazë të periudhës së regjistrimit, deri më datën 17 maj, sot pra reth orës 15:00, kemi bërë procedimin e 983 aplikacioneve për regjistrim, e ku 788 kërkesa për aplikim janë aprovuar, ndërsa, 194 kërkesa kan statusin e ashtëquajtur të pezulluar i cili, pritet që apo janë në pritje të dokumenteve shtes të cilët, edhe janë të informuar me palë të interesuara. Një aplikues, është refuzuar për shkak se aplikacioni nuk e përmbush kriterin që ka të bëjë me moshën për shkak se, është nën moshën 18 vjet. Sa i përket mënyrës së aplikacioneve, pjesa më e madhe jan duke u pranuar përmes imellit. Kemi vetëm 8 votime që jan të pranuar përmes faksit, e po ashtu, është bërë edhe hartimi i programit edhe i trajnimit që ka të bëjë me trajnimin e komisioneve komunale, e që parashihen të mbahen më datën 22-23 maj. Për sa i takon furnizimit, ne i kemi të njoftuar edhe autoritet përkatëse për mënyrën e procedimit.

Tash e mbas aprovimit dhe miratimit, pasi që e kemi buxhetin, tha z. Halimi, kemi filluar procedurat që jan konform rregullatives ligjore dhe t'i sigurojmë materialet ligjore që jan në kohën minimale, e po ashtu, Qendra e Numritmit të Rezultateve, ka filluar që të bëjë përgaditjen në mënyrë që të jetë e gatshme në lidhje me kohën kur do të procesohen por, tash është duke u liruar hapsira dhe, është

duke u akomodua për një masë të madhe për kërkesat që i ka ky proces zgjedhor. Po ashtu, është bërë edhe procedimi i propozimeve për komisione komunale zgjedhore...

Valdete Daka: A ka pyetje ndokush për kryeshefin në lidhje me raportin e tij...?

Betim Gjoshi: Nëse më lejohet, unë e përgjoj për përgaditjen Sekretariatit dhe, ju kerkoj mos m'u nalë me këto përgaditje rreth shërbimit votues jashtë vendit apo votimit nga diaspora...Kisha dashtë me i falenderu ekipin që është duke punuar që m'i ofru mundësi sa më të mira votuesëve jashtë vendit dhe, i kisha inkurajuar kushtet sa ma të mira të punës për ata persona që janë në dispozicion gjatë gjithë ditës për me e lehtësu këtë operacion, ngase është afat i shkurtër: jo për fajin tonë por për shkak të llojit të zgjedhjeve që janë t'u shkue që me pas një pjesmarrje ma të mirë...Ndoshta, për takime tjera na jepet një pasqyrë se nga cilat shtet janë t'u ardhë ma shumë... Edhe diçka: fjala kërkesë a nënkupton 788 persona janë aprovuar, apo 788 imella janë aprovuar që kanë mundur me e pasë një, e më shumë persona...

Enis Halimi: Numrat me sa di unë, janë numrat... flet jo për mënyrën apo mjetin që ata zgjedhin për ta trasmetu një mesazh, por për personin në fjalë që ka drejtë për të votuar..

Adnan Rrustemi: Në fakt, së pari, për këtë çështjen e procesit të listës së votuesve që na e kemi si aktivitet t'oni të brendshëm që, mbrenda mundësive ta kemi jo vetëm si një prioritet...por së paku si një lloj vlerësimi paraprak të alokimit të votuesve të ndarjes së tyre për vendvotime...por, kjo të bëhet e domodoshme edhe si informacion edhe për palët e treat...Edhe ne do ta vëjmë shumë shpejtë në pah, sidomos për kalkulimin e komisionerëve të ekipeve të këshillave të vendvotimeve...Të dimë përafërsisht se sa vendvotime do t'i kemi në këto zgjedhje...Ky, tha z. Rrustemi, është informacion i rëndësishëm edhe për partitë politike pjesë të zgjedhjeve për nevojat e nominimeve për KVV-të, por në ndërkohë, fakti që kemi formuar 100 Qendra të reja të votimit, afërsisht...! Vitin e kaluar, e bënë si të themi, jo referencë aq të përafërt me numrin e vendvotimeve të zgjedhjeve të fundit 2014, d.m.th, se..., nuk e dimë se çfarë impakti ka në shtim të numrit të vendvotimeve apo në zvoglim apo në shpërndarje...

Është mirë, tha ai, që të mos e presim fazën e fundit për ndarje përfundimtare të votuesve për vendvotime për të ditur saktë numrin përfundimtar të vendvotimeve, e kjo, e dimë që ka impakt në trajnime, në sektorin e trajnimeve të komisionerëve, në nominimin edhe në perlllogaritjen e KVV-e, e kështu me rradhë...Sa i përket shërbimit ose regjistrimit të votuesve jashtë vendit, duke qenë se është shumë e shkurtër periudha e shërbimit, dhe mundësitë janë fatkeqësisht të kufizuara për regjistrim, shpresoj shumë dhe kerkoj që Sekretariati të i rritë kapacitetet për këto ditë dhe që, asnjë kërkesë e mergatesë të mos dështoj të mos pranohet për shkak të kapaciteteve tona...Kisha me thënë se, as refuzimi dhe as te miratimi të mos ndërlihet me kapacitetet tona sepse, ato duhet të shtohen... Sa u përket trajnimeve, unë deshta të sigurohem ngase..., edhe nga analiza që kam bërë të Planit Operacional që ka një lloj harmonizimi midis datave të trajnimit të komisionerëve, dhe datave zyrtare kur KQZ-ja i emëron KVV-të...! Edhe këtë çështje që e thash paraprakisht, pra të ndarjes së vendvotimeve, në dokumentim që e kemi të integruar, nuk është i përpunuar apo i

kombinuar trajnimi me datën e emërimit..., por për mua, është me rëndësi ta di se, sa KVV do t'i kemi, dhe kur do t'i kemi...Kur fillon trajnimi..., kjo është shumë informacion i rëndësishëm edhe për partit politike...

Binak Vishaj: Mendoj se është e nevojshme që Sekretariati ta ketë një vëmendje më të shtueme sa i përket votimit jashtë vendit te operacioni zgjedhor ku jemi në fazën ku vazhdojnë me ardhë kerkesa për regjistrim...Mendoj se duhet me u krijuar kushte pune, e numër të të nevojshëm të punëtorëve në rast se paraqitet si kerkesë prej zyrtarëve tanë...Kjo, me të vërtetë është impresionuse për numrin e kërkesave që për dy ditë kanë ardhë...e pata edhe një kërkesë, e që e tha edhe Betimi por që, në takimin tjetër të na vijë

Enis Halimi: Pëer sa i takon drejtësis dhe përshtatjes së resurseve njerëzore, në këtë plan apo në këtë dimension, nuk kemi arsye asnjëherë..., dhe krejt ajo që varet nga ne, arrihet dhe do të arrihet me angazhim të shtuar...Unë ju siguroj se, punohet në dy ndërrime me 16 orë në ditë, pa ndërprerë: procesimi i këtyre aplikacioneve, dhe vlersimi i tyre...Vç atyre që, objektivisht ndoshta është e pamundur që të arrihen për shkak të kohës së shkurtër, të gjitha të tjerave që varen, qoftë alokimi, qoftë resursset njerëzore do të jenë në dispozicion të këtij procesi...

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Sigurisë për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017

Adnan Rrustemi: Këshilli në mbeldhjen e sodit ka shqyrtuar disa çështje që ndërlidhen me procesin zgjedhor...Pika e parë e rendit të ditës, është "Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017" nga KQZ me partnerët e tjerë. Plani operacional i sigurisë i komisionit të zgjedhjeve, dokumenti, synon që të përmbledh përgjegjësitë KQZ dhe palët të tjera, siç është policia e Kosovës për komplet procesin zgjedhor: nga fillimi I fushtatës parazgjedhore dhe kordinimi për mënyren e zhvillimit të tubimeve politike, njoftimi i autoritveve dhe kështu me radhë. Ecurinë deri tek dita e zgjedhjeve, dhe roli bashkloubues midis komisionit të zgjedhjeve dhe policisë, por edhe të prokurorisë në dretim të sigurimit të mbarvajtjes së zgjedhjeve...Plani, parasheh në mënyrë përmbledhëse, këto role dhe këshilli me disa plotesime...Këshilli, rekomandon që ky plan të miratohet...

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan planin e sigurisë

Shqyrtimi dhe miratimi i nominimeve nominimeve për Anëtar të KKZ-ve

Adnan Rrustemi: Faleminderit. Këshilli i Operacioneve Zgjedhore, ka shqyrtuar po ashtu një çështje të rëndësi për procesin zgjedhor: emrimin e komesjoneve zgjedhore, dmth materiali dhe nominimi i subjekteve politike legjitime, është bërë mbreda afatit të caktuar. Ne, kemi trajtuar komunë për komun nominineve duke ju referu ligjeve te kritereve natyrisht por mos mej lexu secili...Në, rekomandojm miratim...Natyrisht se si KOZ duke i marrë parasysh kriteret ligjore bazike, e deri te aspektet, gjithëpërfshirja, e kështu me radhë, rekomandojm që të miratohet rekomandimi ynë..

Valdete Daka: Faliminderit, para jush e kemi një listë me emërime...

Betim Gjoshi: Para se me fillue, ne nuk e kemi mohuar që, i takon me ligj secilit dhe nganjëherë, për me qenë gjithëpërfshirës, e kemi tejkaluar këtë dhe e kemi tejkalu nenin që merret për bazë, dhe me consensus e kemi sjellë listen...

Eshref Vishi: Me siguri, është një lëshim në Deçan, dhe është mirë që Sekretariati me e përmirësue, sigurisht është lëshim...

Adnan Rrustemi: Mungon NISMA...Le të sigurohemi që s'ka pasur nominim, apo...! Mirë, në ndërkohë, edhe e vërtetojmë se për çka bëhet fjalë...Më duket që s'ka pas nominim...

Valdete Daka: Në ndërkohë, e vërtetojmë a ka pas nominim...

Nenad Rikallo: Kam vërejtje në këtë përbërje të KKZ-ve, konkretisht në mjediset ku jeton entiteti serbë...Me ligj, i jepet statuti subjektit që ka qenë në parlament, mirëpo i është dhënë statute subjektit që nuk ka qenë në parlament..., në mjediset ku koncentrimi i nacinalitetit serbë, barazpesha duhet të bëhet...Ua kam tërhequr vërejtjen...mirëpo, subjektit politik të sapo zgjedhur,il është dhënë e drejta e plotë...Unë, nuk pajtohem dhe, nuk është dashur t'i jepet ky status...

Valdete Daka: Ku, në cilat komuna..., konkretisht...?

Nenad Rikallo: Në të të gjitha komunat ku jeton komuniteti serbë, por edhe në disa komuna të tjera: Gjilan, Obiliq, Fushë Kosovë...Pra, është krijuar balans jo i drejtë...

Betim Gjoshi: Shiko, sa i përket kominitet që s'po due tash me fol me emër, e kemi problematikë që, nuk kemi ndonje parti parlamentare qe e kemi bazuar, d.mth., e kemi pasur iniciativë që, ka qenë e përfshirë me shumë persona që ka pas shumë vazhdimësi dhe problematikë...Edhe që e kemi perfaqësuar gjitha komunat...Nuk kemi mujtë me i dhënë vetëm atij subjekti ma shumë se një person, dhe është i përfshirë edhe pse, po mendoj që dikush tjetër është në ato komuna...Është një parti që, është përfaqësuar në kuvende komunale, edhe në ato komuna, edhe e ka historinë ma të gjatë se sa subjektet tjera! Kemi menduar se, ka qenë e vetjma mënyrë që është dashtë me themelu prej njerzëve: jo prej rrugës, por është një subjekt që prap se prapë, ka pas një trashigemi dhe ligjitemitet...

Adnan Rrustemi: Unë thashë që në fillim se, jemi munduar me i respektuar kriteret ligjore, kur bëhet fjalë për grupe parlamentare që behen pjesë e parlamentit, e që janë përfshir në të gjitha rastet që janë bërë nominime. Natyrisht që, mundet dikush me e kontestue strukturën ligjore dhe se ky aspekt, megjithatë është shumë për të deshiru por, është çështje tejtër..., në nderkohë, d.mth., për raste specifike ne i kemi rezervuar edhe rezultatin e zgjedhje lokale, në raste te tilla është e drejtë referimi, është e rëndësishme që nuk është kontestuese ose, që ju ka mohuar ndonjë e drejtë atyre që ju takon, ose që janë pjesë e grupit parlamentar...Në nderkohë, për me e garantuar një proces dhe administrim gjithëpërfshirës, ne iu kemi referuar rezultateve të zgjedhjeve lokale...

Është një fat i mirë që në këto zgjedhje, tha z. Rrustemi, së paku po i eliminojmë organizatat e ndryshme jo qeveritare pa emër, pa numër regjistrimi, pa e ditë kushë perfaqëson, pa e ditur se në cilin vend janë..., Nuk mund të garantojmë kushtimit se kush çka është por, për situatën që ne e kemi, është marrë vlerësimi më gjithëpërfshirës i mundshëm në mënyrë që të kemi sa më pak problem...

Ilir Gashi: Tek Juniku, është lëshim teknik..., në vend të subjektit që është anëtarë, është numri i telefonit...Bëjeni përmirësim...!

Binak Vishaj: Faliminderit. Unë e kam një pyetje për kshillin: Te komuna e Mitrovicës së veriut, a ka pasë kërkesë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, se në zgjedhjet e fundit ne kemi pas antarë në komisionin komunal zgjedhor... edhe mendoj që ka pasur prapë kërkesë, por nuk po e shohë këtu...!

Adnan Rrustemi: Por, unë si anëtar i këshillit ose si kryesus i këshillit, krejt çka muj me bartë qëndrimin ose me bartë qëndrimin e kshillit, jo domesdeshmerisht...sipas mendimin tim ose nga pikëpamja ime, këshilli ka pasur parasysh masat e tilla të merren për bazë, ose po e quaj "ekulibrimi" dhe të perfaqësuarit e kritrit etnik, dhe kjo siç ka ndodhur me AAK-në ka ndodhur edhe me partitë e tjera si VV, PDK...por, edhe subjekteve tjera. Këshilli ka vendosë kështu, është vendosur kriteri në formulë që në këto komuna të ketë 3 parti përkatëse të komunitet shqiptar në baz të rezultatit të votive...Pra, ashtu siç ka qenë renditja në zgjedhjet e fundit, kështu që kjo është e diskutueshme por, është vendosur në bazë të parimit të njëjtë për të gjithë... Grupet parlamentare kanë të drejtë në parim, tha z. Rrustemi, por edhe njëherë po e theksoj se, është vendosur në bazë të kriterit të votës...

Binak Vishaj: Edhe njëherë: i kemi 1.2.3.4.5 komuna ku janë shpërndarë 3 parti, dhe në asnjë prej tyre nuk është AAK. Duke filluar nga prejGracanicës, Ranillugut, PArteshit, Kllokotit dhe Mitrovicës së Veriut...

Adnan Rrustemi: Në parim, grupet parlamentare kanë të drejtë...Por, janë dy çështje të diskutueshme: parimi, ose kriteri i votës! KOZ ka vendosur kështu, KOZ mundet me vendosur ndryshe...

Ergit Qeli: Faliminderit kryetare...Po, edhe ne si parti, në fakt si Partia Liberale Egjiptiane që i ka nominuar 12 persona..., po na mungojnë shumë në mesin e tyre...Kisha pasur dëshirë që të keni konsideratë që bile në disa komuna me u plotësuar, meqë nuk kemi...Si, në komunën e Istogut, Prizrenit, Rahovecit...

Betim Gjoshi: Jo, ne i kemi përfaqësuar të gjitha komunitetet në bazë të fuqisë politike...Jemi munduar, por po dikutojmë ne, mirëpo Sekretariati është dashur me e kryer këtë punë...

Betim Gjoshi: Kryetare, e kemi parë që procesin e nominimeve, krahasuar me zgjedhjet e kaluara, që kur unë jam anëtarë i KQZ...Kemi evndosur duke u bazuar në rezultatet në atë komunë edhe në bazë të grupeve parlamentare të nivelit qendror, siç e kemi pasur gjithmonë, e dyta janë marrë nominime më shumë se kurdoherë tjetër, e trea, janë më të mëdhaja se kanë qenë ndonjëherë tjetër, e ligji lejon vetëm 7 vetë, por se di a kemi ndonjë dy – tri KKZ me 7 veta, krejt i kemi me 8,9,10 e madje me 11 veta...

Ercan Spat: Me vëmendje u mundova si të gjithë anëtarët e këshillit me punuar por, edhe tashti me ndëgju ju kolege të nderuar por po m' duket se kur po na vijnë interes subjektive disi jemi më emotive, disi nuk mund ta frenojmë vetën. Fillimisht, dua të ju përkujtoj se jemi në zgjedhje të cilat janë caktuar të mbahen brenda 30 diteve, dikush prej parafolesve përmendi se, ku është degraduar sistemi. Unë, sinqerisht s'kam njohuri për punët në zgjedhjet e mëhershme ngase nuk isha anëtarë i këshillit por, jo vetëm se subjektet politike janë vonuar dhe ne kemi përjetuar sot detaje që në takimet të shtojmë emra disa subjekte s'kan arritur as emrat me i dorzuar në fund të fundit ne këtu kemi edhe një listë bile, po duket se po na mungojn. Çështja, nuk është aq e thjeshtë që të akuzojm tash këto thjeshtë që të akuzojme njerën ane apo anën tjetër por t'i ikim pak emocioneve. Mendoj se, është munduar këshilli të bëjë një zgjidhje për këto kushte ideale. Kolegu im i nderuar, e përmendi Prizrenin! Unë, dua të nënvizoj se isha edhe personalisht, dhe veç anëtarëve të tjerë, u përmend me koncesus kemi vendosur zuku , tjetër edhe perfaqesuesi i dyte i Boshnjakeve ne qytetin e Prizrenit sepse dy subjektet te cilat jane ne propozimin i cili KQZ-ja vendos ne fund te fundit a duhet ndyshuar ishujn dy subjekte të cilët, i kishin votat gati të njëjta edhe në zgjedhjet e fundit, cili është parlamentare e cili, është bazë edhe në zgjedhjet lokale ashtu që, ky propozimi, nëse është gabim, ajo përmirësohet.

Valdete Daka: A ka dikush diçka tjetër me shtue ? Nëse jo, atëherë, unë e hedh në votim këtë listë.

Kush është për aprovimin e kësaj liste ? Kush është kundër...?

Anëtarët e KQZ-së, me një votë kundër (Nenad Rikallo), miratuan këtë rekomandim të KOZ-it.

Shqyrtimi i Dizajnit të Doracakut për procedurat e votimit dhe numërimit.

Adanan Rustemi: Në fund, e kemi doracakun për trajnimin e komisionerëve për këto zgjedhje. Në fakt, nuk e kemi përmbajtjen e tij. Përmbajtjen, e kemi rehatuar disa ditë më parë, respektivisht, disa ditë para shpalljes së zgjedhjeve në pretendimin për ta miratuar një dokument të integruar dhe të përhershëm për trajnime e stafit të administrimit të zgjedhjeve. Siç e dimë, doracaku ka pësuar ndryshime rrënjësore, si në formë dhe si në përmbajtje. Është më i përshtatshëm, do të thoja unë, për bartjen e njohurive për të gjithë komisionerët që do të përfshihen në procesin zgjedhor. Është, i plotësuar me skema dhe ilustrime që e letësojnë mësimnxënjen, dhe në fund, sot e kemi rekomandimin për ta miratuar në tërësi si dizajn, pa u lëshuar në përmbajtje konkrete, kështu që këshilli i operacionit

zgjedhor e rekomandon KQZ-në që ta miratoj dizajnin mbi, ose për doracakun e trajnimit të komisionerëve. Megjithatë, qithate une mduhet ta falenderoj ajfeci ka dhene nje ndihme te dobishme ne drejtim edhe te zhvillimit edhe te krijimit por edhe te dizajnit .

Valdete Daka: A ka dikush ndonjë pyetje për doracakun ? Nëse jo, atëherë kush është për aprovimi e tij?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan doracakun për procedurat e votimit dhe numërimit ...

Adnan Rrustemi: Kshilli operacioneve zgjedhore, ka trajtuar edhe procedurën e qendrës së numërimit mbi procesin ose aktivitetet që zhvillohen në qendrën e numërimit.Procedura përgjithsisht, është e njejtë dhe nuk ka pësuar ndryshime, përjashto plotësimin në faqen 24 për anëtarët e tjerë që nuk janë pjesë e këshillit operacional zgjedhore që është plotësuar me aktivitetet që rezultojnë nga dy projekte që i ka miratuar KQZ-ja më parë për skanimin e formulareve të rezultateve FPRK DHE FRD. Është përshkruar procesi në tërësi se si ndodhin këto aktivitete. KQZ, ka marrë vendim që në QNR të skanohen si fotografi të gjitha këto kopje të këtyre formulareve për secilin vendvotim që të ju ofrohen palëve pjesë të procesit zgjedhor, anëtarëve të KQZ-së, po edhe përfaqësuesve të partive politike me qëllim për ta rritur transparencën sa i përket të dhënave të plotësura në çdo vendvotim. Procedura, siç e thash përfshinë të gjitha aktivitetet e QNR-së: nga pranimi i materialeve, deri tek tabulimi dhe shpallja e rezultateve përfundimtare. KOZ, i rekomandon KQZ-së ta miratoj si të tillë këtë procedurë, megjithëse, u ngriten disa çështje edhe nga antëret e KOZ-it dhe nga kordinatori i QNR-së që të shihet mundësia që të zgjerohet edhe gama, edhe hapësira, edhe numri i vëzhguesve të subjekteve politike për aktivitete në QNR.

Valdete Daka: Faleminderit, para se ta shqyrtojme rekomandimin, le te futet si pike e rendit te dites. Se, nuk është nën pikë e KOZ-it!

Betim Gjoshi: Kryetare, nashta veç diqka, t`jem ma të qartë në kushte normale ne sot se kishem miratu këtë procedurë se është e njëjta, me përjashtim të dy projekteve që na i kena miratuar që janë: rritja e transpencës në QNR që ka të bëjë me skanimin e formulareve të rezultateve për kandidat për subjektet politike, ku ne tashmë do ti kemi partitë gjith formularët e skanum për subjektet e interesume, dhe kjo është ndryshimi i vetëm. Kemi kërkue në QNR-s me e rrit kapacitetin e punës për me krye ma shpejt dhe mos me pritë rezultate m'u vonu 15-20-30 ditë qysh na ka ndodh për rezultat përfundimtar...

Valdete Daka: Faleminderit Betim. A ka dikush ndonjë pyetje? Nëse jo, kush është për aprovim?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan edhe këtë propozim.

4. Shqyrtimi i Memorandum Mirëkuptimit mes KQZ-së dhe Zyrës së BE-së, për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër, e ajo është shqyrtimi i memorandumit të mirekuptimit të KQZ-s dhe zyren e BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme. Siq e dini, ne kemi pas një marrveshje të tillë të nënshkruar edhe në vitin 2014 dhe 2013 nga Bashkimi Evropian. Edhe këtë herë, do të kemi një mision vëzhgues i cili, shumë shpejtë do të jetë present në Kosovë, dhe që të bëhet e mundshme neve na duhet të nënshkruajmë një memorandum të mirëkuptimit në mes të KQZ-së dhe Bashkimit Evropian. E keni draftin para jush, e keni pas besoj edhe koheëme e shqyrtuar. A ka dikush ndonje vërejtje?

Betim Gjoshi: Nëse më lejoni...? Mua më gëzon fakti që Bashkimi Evropian, ka shpreh gadishmëri me ju pergjigj ftesës sonë për vëzhgim të zgjedhjeve. Ju sic e dini, unë qysh në mledhjen e parë, ditën që janë shpallë zgjedhjet, kam kërkuar që Bashkimi Evropian të jetë present si vëzhgues afatgjatë, në këtë rast, i procesit Zgjedhor në Kosovë, dhe e mbështesë këtë memorandum mirekuptimi...

Valdete Daka: Faleminderit Betim, unë sot nga zonja Apostollova, mora komfirmin që do të jenë 100 vëzhgues të cilët, do të zbarkojnë të shtunën në Kosovë. Kishte me qenë mirë që ky memorandum, të nënshkruar para ardhjes së tyre se, vetëm me nënshkrimin e memorandumit, do të mundet që ata, të fillojnë faktikisht vëzhgimin e gjithë procesit që nga ajo ditë. Pra, unë kërkoj, rekomandoj që ky memorandum të nënshkruhet sa më shpejtë...

Enis Halimi: E kemi edhe një pikë të rendit të ditës e cila pikë, është propozuar nga kryeshefi, dhe se bëhet fjalë për një pikë ndryshimi të rregullores së Sekretariatit që ka të bëj me nenin 24, pika 1 që lidhet me menaxhimin financiar...dhe që lidhet me çështjen e kompetencave...Ky propozim, ka qen i shqyrtuar edhe në këshillin e çështjeve ligjore dhe, është procedu në KQZ, me plotësimin që është bërë në kuadër të të gjitha rregulloreve. Njëra prej arsyeve që e kemi diskutuar edhe ma herët që do të miratohet ky plotsim dhe ndryshim për shkak se, tash jemi në proces zgjedhor dhe e kemi të ngutshmën dhe të procedojmë pa ndonjë cenim të rregullativës që i rregullon këto çështje për të cilat, bëhet fjalë.

Valdete Daka: Kush është për këtë ndryshim i cili, i përfundon këto procedura që parashihen me ligj...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan edhe këtë propozim.

Per KQZ

Valdete Daka, kryetare
